

ARTAN MIRASHI



Auditues i Lartë nga viti 2010, në Departamentim e Auditimit të të Ardhurave të Buxhetit të Shtetit, KLSH.

Lindur ne vitin 1962. Diplomuar në Inxhinieri Naftë(1996), Jurisprudencë(2006) dhe Master në Administrim-Biznes(2008).

27 vite eksperience pune.

21 vitet e fundit si auditues në KLSH.

Fusha e ekspertizës: Auditimi i të Ardhurave të Buxhetit të Shtetit dhe auditimi I pushtetit vendor.

PERMIRESIMI I MENAXHIMIT TE BUXHETIT VENDORⁱ

nga Artan Mirashi

Reforma e decentralizimit fiskal ka patur efekte pozitive, si ne rritjen e te ardhurave vendore ashtu dhe ne rritjen e te ardhurave nga taksat dhe tarifat vendore perkundrejt te ardhurave nga transferta e pakushtezuar e buxhetit te shtetit.

Autonomia financiare e pushtetit vendor eshte rritur nga viti ne vit. Ne vitin 1996, organet e qeverisjes vendore kishin te drejte te vendosnin vetem per 1 perqind te buxhetit te tyre. Ne vitin 1997 kjo autonomi ishte 3 perqind, ne vitin 1998, 2 perqind, ne vitin 1999, 12 perqind, ne vitin 2002, 31 perqind, ne vitin 2003, 32 perqind, ne 2004, 35 perqind, ne 2005, 36 perqind, ne vitin 2006, 41 perqind ne vitin 2007, 42 perqind dhe ne vitin 2008 e deri me sot, mbi 45 perqind.

Nga viti 2007 dhe ne vazhdim e gjithe pergjegjesia per mbledhjen dhe administrimin e te ardhurave nga taksa e biznesit te vogel ka kaluar ne

organet e qeverisjes vendore. Kjo mase perben nje hap tjetër pozitiv në drejtim të rritjes së autonomisë fiskale vendore.

Misioni i pushtetit vendor

Misioni i pushtetit vendor përben një nga elementet e domosdoshëm për të siguruar raporte të qarta ligjore të qëndrueshme në mes pushtetit qendror e pushtetit vendor. Në mënyrë të veçantë behet ndarje e funksioneve në: *a) funksione të veta të pushtetit vendor, b) funksione të përbashkëta në mes dy pushteteve, c) funksione të deleguara nga një nivel në një tjetër.*

Përcaktohen funksionet e veta të pushtetit vendor. Në mënyrë të përmbledhur evidentojmë funksionet në fushën e infrastrukturës vendore dhe shërbimeve publike, në shërbimet me karakter social, kulturor e sportiv, në zhvillimin ekonomik vendor dhe për rendin e mbrojtjen civile.

Jepen instrumentet për ushtrimin e funksioneve nëpërmjet përcaktimit të kompetencave konkrete të grupuara në: *kompetenca administrative - struktura, paga etj, kompetenca shërbimi - mirëmbajtje, kompetenca rregullatorë -licenca, përcaktim orari, standarde etj, kompetenca investimi - angazhimi për të kryer investime.*

- Behet përcaktimi i të drejtës së pronarit në lidhje me pronat që janë të lidhura drejtpërdrejt me funksionet e pushtetit vendor.
- Behet përcaktimi i autonomisë financiare, si kusht i domosdoshëm për realizimin e funksioneve dhe kompetencave.

Fuqizimi i burimeve financiare të pushtetit vendor

Fuqizimi i burimeve të veta financiare realizohet nëpërmjet: *zgjërimit të strukturës së taksave, të drejtës për përcaktimin e nivelit të taksave të drejtës për përcaktimin e tarifave vendore.*

Përmirësimi i raporteve të buxhetit të shtetit me buxhetin vendor realizohet nëpërmjet *përmirësimit të mënyrës së shpërndarjes, ndarja e disa lloj taksash e tatimesh.*

Disa nga faktoret dhe politikat kyçe të qeverisë që do të mbështesin perspektivën e rritjes ekonomike e zhvillimit social në një ambient makroekonomik të qendrueshëm duhet të jenë:

- Te rritet besimi i biznesit duhet që Qeveria të heqi barrierat institucionale, në sistemin rregullator të biznesit dhe në atë fiskal, ç'ka bën të mundur rritjen e investimeve dhe zhvillimin e sektoreve ekonomike kyçe.
- Vijimesia e konsolidimit fiskal, forcimi i metejshëm i administrimit dhe menaxhimit të të ardhurave, rritja e efikasitetit të shpenzimeve publike, zgjatja e afatit të maturimit e reduktimi i nivelit të borxhit të brendshëm, adresimi i financimit të huaj kryesisht në financimin e shpenzimeve kapitale, përmirësimi në balancat korente dhe primare, marrja e masave rregullative të tregut dhe përdorimi i incentivave fiskale që sigurojnë mbështetjen e investimeve publike dhe private.
- Investimet publike duhet të ndjekin një trend rritës në vitet e ardhshme, duke ndikuar sidomos në përmirësimin e infrastruktures rrugore, shërbimeve të arsimit e shëndetësisë, si edhe të furnizimit me energji elektrike. Duke u përqendruar kryesisht në ndërtim (ndërtesa për ushtrimin e aktiviteteve të bizneseve e ndërtesa banimi) dhe teknologji (rinovim teknologjic, zgjerim i kapaciteteve prodhuese e mirëmbajtje të tyre).
- Rritja e vazhdueshme e investimeve të brendshme e të huaja private, të nxitura prej politikave lehtësuese fiskale e monetare, pakesimit të barrierave administrative e prej një ambienti të qendrueshëm makroekonomik.
- Rritja e investimeve për makineri, pajisje, trajnime, si edhe politikat mbështetëse fiskale për nxitjen e investimeve dhe zhvillimin teknologjik do të rrisin produktivitetin e fuqisë punëtore.

- Ndjekja e nje politike monetare te kujdesshme, mbajtja e inflacionit brenda intervalit 2-4 perqind, koordinim edhe me efikas i politikes fiskale e monetare dhe ruajtja e stabilitetit financiar.
- Privatizimi i sektoreve strategjike, si ai i shperndarjes se energjise elektrike, telekomunikacionit, nxjerrjes dhe perpunimit te naftes etj, do te ndihmojne ne permiresimin e klimes se biznesit dhe do te rrisin eficencen prodhuese te ekonomise.
- Rritja, permiresimi dhe zhvillimi i metejshem i sistemit financiar, bankar dhe jo-bankar, bazuar ne: nje sistemin financiar shqiptar me likuiditet te mjaftueshem dhe te disponueshem per biznesin
- Rritja e masave te mbikeqyrjes se cilesise se huadhenies nga sistemi bankar dhe jo-bankar dhe vazhdimi i procesit te rritjes se shkalles se ndermjetesimit financiar nepermjet: (i) permiresimit te cilesise se sistemit te pagesave; (ii) permiresimit te cilesise se portofolit te kredive nga tregu bankar dhe jo-bankar; dhe (iii) rritjes se shkalles se qarkullimit te mjeteve monetare nepermjet sistemit bankar.
- Ruajtja e pozicionit te qendrueshem te bilancit te pagesave, e shprehur ne: (i) mbajtjen e nje niveli te mjaftueshem te rezervave valutore, (ii) reduktim te defiçitit te llogarise korente, (iii) rritje te investimeve te huaja direkte dhe hyrjeve neto kapitale.
- Konsolidimi dhe rritja e te ardhurave vendore perben nje nga objektivat per garantimin e qendrueshmerise se reformes se decentralizimit.
- Rritja e performances ne menaxhimin e asetave vendore si nje instrument i rëndësishme per rritjen e te ardhurave vendore dhe rritjen e investimeve per infrastrukturën vendore. Kalimi i asetave ne pronesi te njesive te qeverisjes vendore ofron mundesira te medha per rritjen e te ardhurave financiare nepermjet perdorimit te tyre nga vete njesite vendore ose nga te tretet si dhe

nepermjet rritjes se koletaralit per marrje kredi per financim te investimeve publike.

- Nepermjet perdorimit te mekanizmave financiare per shperndarjen e subvencioneve do ndikohet ne rritjen e performanes se menaxhimit te SH.A-ve dhe ndermarrjeve te ujesjelles-kanalizimeve ne njesite e qeverisjes vendore.
- Asistimi dhe inkurajimi i njesive vendore per te marre hua dhe kredi me qellim ndertimin dhe rikonstruksionin e infrastruktures vendore.
- Reforma e decentralizimit fiskal do te perqendrohet ne saktesimin e marredhenieve fiskale midis pushtetit qendror dhe atij vendor.
- Kjo do te realizohet nepermjet hartimit dhe miratimit te ligjit per financat vendore, i cili do te synoje te percaktoje; proçeduren e hartimit dhe zbatimit te buxhetit vendore, skemen e financimit te transfertes se pakushtezuar per pushtetin vendor, problemet e kontabilitetit dhe auditit te brendshem dhe te jashtem, transparencen dhe llogaridhenien.

Kjo reforme, ndersa rrit mundesite per te ardhura me te medha vendore, perfaqeson nje reforme me risqe minimale. Ajo eshte e bazuar mbi pervojat e perfituara te njesive te qeverisjes vendore ne administrimin e taksave vendore, dhe mbeshtetet ne nje baze taksash solide dhe ne rritje, brenda nje parashikimi te pergjithshem te rritjes ekonomike. Ajo do te perfitoje, gjithashtu, nga motivimi me i madh i zyrtareve vendore per te kontribuar ne permiresimin e mbledhjes se te ardhurave, duke perfshire nxitjen e bashkepunimit te ngushte ndermjet administratave qendrore dhe vendore, kjo e kodifikuar me ane te nje kuadri te qarte ligjor.

ⁱ Botuar në Gazetën “Ekonomia” dt. 20 Qershor 2013